



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur mbi kufirin e lartë monetar

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “Furnizim dhe vendosje e orendive dhe pajisjeve të mobilimit për shkollën ‘Marigo Posio’, Bashkia Vlorë” “

Fondi limit : 13,313,629.5 (Trembedhjetë million e treqind e trembedhjetë mijë e gjashtëqind e njezet e nente pike pese) Leke pa tvsh

Fondi Limit : 143,527.7 (njeqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e njezet e shtatë pike shtatë) Euro

Kodi CPV: 39160000-1 – Mobilje shkollore

Tipi i Proçedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-96799-08-20-2026

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 15 dite

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, sipas përcaktimeve ligjore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kërkesa për paraqitjen e bilanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025** është përcaktuar me qëllim verifikimin e **kapacitetit ekonomik dhe financiar** të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së tyre financiare për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Bilancet dhe pasqyrat financiare përbëjnë dokumentacionin financiar të nevojshëm për të vlerësuar gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik, duke i dhënë autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë nëse operatori ka një situatë financiare të qëndrueshme dhe aftësi për të përballuar detyrimet financiare që lidhen me realizimin e kontratës. Kërkesa për **tre vite financiare të**

njëpasnjëshme është vendosur për të siguruar një vlerësim më të plotë të gjendjes financiare të operatorit ekonomik dhe për të shmangur vlerësimin e kapacitetit financiar vetëm mbi bazën e një viti të vetëm. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor mund të evidentojë nëse gjendja financiare e operatorit ka qenë e qëndrueshme në kohë. Përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur kur, në **dy nga tre bilanci e kërkuara**, nuk rezulton gjendje financiare negative, synon të shmangë përjashtimin e operatorëve ekonomikë për shkak të një rezultati financiar jo të favorshëm në një vit të vetëm, duke vlerësuar në mënyrë më proporcionale dhe objektive qëndrueshmërinë e tyre financiare.

Kërkesa që bilanci të jenë **të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse** synon të garantojë autenticitetin dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit financiar të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në rastet kur operatori ekonomik është subjekt i auditimit ligjor sipas **nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009**, kërkesa për paraqitjen e raporteve të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është e nevojshme për të siguruar një verifikim të pavarur të informacionit financiar të paraqitur dhe është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës. Nga pikëpamja teknike dhe ekonomike, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik që do të realizojë kontratën të ketë **kapacitet të mjaftueshëm financiar, stabilitet ekonomik dhe aftësi për të përballuar kostot dhe detyrimet që mund të lindin gjatë zbatimit të saj**, duke reduktuar riskun e ndërprerjes ose mosrealizimit të kontratës për shkaqe financiare. Kriteri është vendosur në përputhje me parimet e **proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë**, pasi kërkesa lidhet me objektin dhe natyrën e kontratës dhe nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë që operatorët pjesëmarrës të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e saj.

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për kestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

Kërkesa për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore është vendosur për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore të operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore. Verifikimi për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ushtron aktivitet, sipas të dhënave të QKB-së, siguron kontroll të plotë të detyrimeve të tij vendore. Kriteri është i lidhur me gjendjen ligjore të operatorit ekonomik dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë ofertuesit, ndërsa dokumentacioni provues kërkohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari sipas përcaktimeve të DST.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm,

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Argumentimi Teknik : Kërkesa për paraqitjen e dëshmive për **furnizime të mëparshme të ngjashme**, të realizuara gjatë **3 (tre) viteve të fundit**, është përcaktuar me qëllim verifikimin e eksperiencës dhe kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të objektit të kontratës. Duke qenë se objekt i procedurës është **furnizimi i mallrave**, përmbushja e kontratës kërkon që operatori ekonomik të ketë eksperiencë të mëparshme në realizimin e furnizimeve të natyrës së ngjashme, duke garantuar njohjen me kërkesat teknike, organizimin e furnizimit, sigurimin e mallrave, respektimin e afateve të dorëzimit dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Përcaktimi i vlerës minimale të furnizimeve të ngjashme në masën **40% të vlerës së fondit limit** synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë të mjaftueshme dhe të provuar në realizimin e kontratave me një volum ekonomik të krahasueshëm me atë që do të prokurohet, duke ulur riskun e mosrealizimit ose realizimit jo të plotë të kontratës. Ky nivel kërkesë konsiderohet **proporcional me objektin dhe vlerën e kontratës**, pasi nuk kërkohet që operatori ekonomik të ketë realizuar më parë furnizime në vlerë të barabartë me fondin limit apo më të lartë se ai, por vetëm një nivel të arsyeshëm të eksperiencës së mëparshme. Kufizimi i periudhës së referencës në **3 (tre) vitet e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** synon të sigurojë që eksperiencia e paraqitur të jetë aktuale dhe relevante, duke treguar se operatori ekonomik ka kapacitetin dhe strukturën e nevojshme për të realizuar furnizime të ngjashme në kushtet aktuale të tregut. Kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese, si **vërtetimet e lëshuara nga entet publike dhe/ose faturat tatimore të shitjes**, ka për qëllim të mundësojë verifikimin objektiv të furnizimeve të deklaruara, për sa i përket **datës së furnizimit, vlerës dhe sasisë së mallrave të furnizuara**, si dhe faktit që këto furnizime janë realizuar dhe deklaruar në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Për furnizimet e realizuara me subjekte private, kërkesa për paraqitjen e faturave tatimore të shitjes, të deklaruara pranë organeve tatimore, shërben si dokument provues i realizimit faktik të furnizimit dhe i vlerës së tij. Në këtë mënyrë, kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë **eksperiencë të mjaftueshme, të verifikueshme dhe të lidhur me objektin e kontratës**, duke minimizuar riskun për autoritetin kontraktor dhe duke rritur sigurinë për realizimin me sukses të furnizimit, pa vendosur kërkesa të panevojshme ose joproporcionale ndaj operatorëve ekonomikë.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e FV objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **10 (dhjetë) punonjësish**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum për muajin e fundit të deklaruara nga data e hapjes së ofertave vertetuar me :

- **Vërtetim të lëshuar Administrata Tatimore**, për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;
- **Listëpagesat e punonjësve**, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik për kriterin Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një **fuqi punëtore minimale prej 10 (dhjetë) punonjësish** është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, volumin dhe kompleksitetin e furnizimit objekt kontrate, si dhe nevojën për të garantuar realizimin e tij në përputhje me kërkesat teknike dhe afatet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Disponimi i një numri të mjaftueshëm punonjësish është i nevojshëm për të siguruar kapacitetin organizativ dhe operacional të operatorit ekonomik gjatë realizimit të kontratës, duke përfshirë, sipas natyrës së furnizimit, **organizimin e mallrave, përgatitjen, ngarkimin, transportin, shkarkimin, sistemimin dhe vendosjen e tyre në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor**, si dhe realizimin në kohë të të gjitha detyrimeve që lidhen me furnizimin. Përcaktimi i numrit minimal prej **10 punonjësish** synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitet të mjaftueshëm njerëzor për të përballuar volumin e furnizimit dhe për të shmangur vonesat në realizimin e kontratës, veçanërisht në rastet kur furnizimi dhe vendosja e mallrave duhet të kryhen në disa ambiente ose në një periudhë të përcaktuar kohore. Kërkesa që punonjësit të rezultojnë të deklaruar në **listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave** synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon realisht dhe në mënyrë të qëndrueshme burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës dhe se fuqia punëtore e deklaruar nuk është krijuar vetëm për qëllime të pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Përcaktimi i muajit të fundit të deklaruar si periudhë reference siguron që kapaciteti njerëzor i operatorit ekonomik të jetë **aktual në momentin e zhvillimit të procedurës** dhe të pasqyrojë situatën reale të burimeve njerëzore të disponueshme. Kërkesa për paraqitjen e **vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listëpagesave të punonjësve**, të konfirmuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, synon të mundësojë verifikimin objektiv të numrit të punonjësve të deklaruar dhe të shmangë deklaratimet e

pambështetura në dokumentacion zyrtar. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është përcaktuar në funksion të sigurimit të kapacitetit teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin me sukses të furnizimit, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Përmbushja e kriterit nëpërmjet **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit** dhe verifikimi i dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit, siguron një proces efikas verifikimi, duke i dhënë autoritetit kontraktor mundësinë të kontrollojë dokumentacionin justifikues përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

2.3.3.Operatori ekonomik duhet te disponoje nje staf me kualifikimet e meposhtme :

1 (nje) Inxhinier druri ne rast se eshte prodhuese vertetuar me :

- kontrate individuale te punes (te vlefshme)
- diplomen qe verteton kualifikimin profesional te mesiperm.

1 (nje) Marangoz/mobilier/montues mobiljesh vertetuar me :

- kontrate individuale te punes (te vlefshme)
- diplome/deshmi qe verteton nivelin e kualifikimit arsimor leshuar nga institucionet publike/private te licensuara sipas ligjit nr.15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH " te ndryshuar.

2 (dy) Punonjes te thjeshte per veprimtari ndihmese ngarkim-shkarkimi vertetuar me :

- kontrate individuale te punes (te vlefshme)

Operatori ekonomik duhet te paraqese Listëpagesat e punonjësve, te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknikKërkesa për disponimin e stafit me kualifikimet e përcaktuara në kriterin 2.3.3 është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës, i cili lidhet me **furnizimin, prodhimin sipas rastit, transportin, montimin dhe vendosjen e mobiljeve**, si dhe nevojën për garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.Kërkesa për **1 (një) inxhinier druri**, në rastin kur operatori ekonomik është prodhues,synon të garantojë disponimin e një personi me formim profesional të përshtatshëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin teknik të proceseve të prodhimit të produkteve prej druri dhe materialeve të ngjashme. Prania e një personi të kualifikuar në këtë fushë ndihmon në garantimin e respektimit të parametrave teknikë, materialeve, përmasave, konstruksionit dhe cilësisë së produkteve të furnizuara.Kërkesa për **1 (një) marangoz/mobilier/montues mobiljesh** lidhet drejtpërdrejt me natyrën e furnizimit dhe nevojën për personel të specializuar për **montimin, instalimin, përshtatjen dhe përfundimin e mobiljeve** në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Kualifikimi profesional i këtij punonjësi garanton që procesi i montimit të realizohet në mënyrë profesionale dhe në përputhje me kërkesat teknike.Kërkesa për **2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse të ngarkim-shkarkimit** është përcaktuar për të siguruar kapacitetin njerëzor të nevojshëm për manipulimin, transportimin, ngarkimin, shkarkimin dhe sistemimin e mallrave gjatë procesit të furnizimit. Kjo është veçanërisht e nevojshme për të shmangur dëmtimin e mobiljeve gjatë manipulimit dhe për të garantuar realizimin e furnizimit brenda afateve të përcaktuara.Kërkesa që personeli i mësipërm të jetë i lidhur me operatorin ekonomik nëpërmjet **kontratës individuale të punës të vlefshme** synon të sigurojë se operatori ekonomik disponon realisht burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës dhe se personeli i deklaruar është i angazhuar në mënyrë të rregullt dhe të verifikueshme.Për personelin e kualifikuar kërkesa për paraqitjen e **diplomës ose dëshmisë së kualifikimit profesional** shërben për të verifikuar objektivisht përputhjen e formimit dhe kualifikimit të punonjësve me funksionin që do të kryejnë gjatë realizimit të kontratës.Paraqitja e **listëpagesave të punonjësve për muajin e fundit të deklaruar**, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, synon të verifikojë disponimin real dhe aktual të stafit të deklaruar nga operatori ekonomik.Kërkesa për këtë strukturë minimale të stafit është përcaktuar në mënyrë të lidhur me nevojat konkrete të realizimit të kontratës dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por **garantimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik**, në mënyrë që furnizimi, montimi dhe vendosja e mobiljeve të realizohen në përputhje me specifikimet teknike, standardet e kërkuara dhe afatet kontraktore.Kriteri konsiderohet proporcional me objektin e kontratës, pasi kërkohet vetëm një **numër minimal dhe funksional i personelit**, i ndarë sipas roleve që lidhen drejtpërdrejt me procesin e prodhimit, montimit dhe manipulimit të mobiljeve.

2.3.4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, me të cilën angazhohet të garantojë mallrat objekt prokurimi për një periudhë 1 (një) vjeçare, duke filluar nga data e dorëzimit dhe pranimit të tyre nga Autoriteti Kontraktor.

Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik angazhohet të kryejë pa pagesë riparimin, zëvendësimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e nevojshëm për çdo defekt ose dëmtim që rezulton se vjen si pasojë e prodhimit, materialeve të përdorura ose montimit. Shërbimi i garancisë do të kryhet brenda një afati të arsyeshëm nga marrja e njoftimit nga Autoriteti Kontraktor dhe pa shkaktuar kosto shtesë për Autoritetin - Kontraktor.

Argumentimi : Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës

Argumentimi teknik Kërkesa për paraqitjen e një **deklarate garancie për një periudhë minimale prej 1 (një) viti**, duke filluar nga data e dorëzimit dhe pranimit të mallrave nga Autoriteti Kontraktor, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e mallrave objekt prokurimi, përdorimin e tyre të vazhdueshëm dhe nevojën për të garantuar cilësinë dhe funksionalitetin e tyre gjatë periudhës së përdorimit. Mobiljet objekt kontrate janë produkte që do të përdoren në mënyrë të përsëritur dhe për një periudhë të gjatë kohore. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të garantojë që mallrat e furnizuara të jenë në përputhje me specifikimet teknike, të jenë të prodhuara me materiale cilësore dhe të mos shfaqin defekte që lidhen me procesin e prodhimit, materialet e përdorura apo montimin. Periudha minimale e garancisë prej **1 (një) viti** synon t'i japë Autoritetit Kontraktor një siguri të arsyeshme mbi cilësinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe të mundësojë evidentimin dhe korrigjimin e defekteve që mund të shfaqen gjatë përdorimit normal të tyre. Përcaktimi që operatori ekonomik të kryejë **pa pagesë riparimin, zëvendësimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e nevojshëm** për defektet ose dëmtimet që vijnë si pasojë e prodhimit, materialeve të përdorura ose montimit, synon të garantojë përgjegjësinë e operatorit ekonomik për cilësinë e mallrave të furnizuara dhe të shmangë krijimin e kostove shtesë për Autoritetin Kontraktor. Kërkesa për ndërhyrjen e operatorit ekonomik brenda një **afati të arsyeshëm nga marrja e njoftimit** synon të sigurojë vazhdimësinë e përdorimit të mallrave dhe të minimizojë çdo pengesë që mund të shkaktohet nga defektet gjatë periudhës së garancisë. Nga pikëpamja teknike, kjo kërkesë shërben si një mekanizëm kontrolli të cilësisë pas dorëzimit dhe pranimit të mallrave, duke nxitur operatorët ekonomikë të garantojnë cilësi të përshtatshme të materialeve, përpunimit dhe montimit. Kërkesa për garanci është **e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e mallrave**, pasi synon të sigurojë që mobiljet e furnizuara të ruajnë funksionalitetin dhe karakteristikat e tyre të kërkuara gjatë periudhës minimale të garancisë. Në këtë mënyrë, kriteri garanton një nivel të përshtatshëm sigurie për Autoritetin Kontraktor dhe përdoruesit përfundimtarë, duke reduktuar riskun e furnizimit me produkte me defekte dhe duke siguruar që çdo problem që lidhet me prodhimin, materialet ose montimin të trajtohet nga operatori ekonomik pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë, në pronësi, me qira ose në përdorim të ligjshëm, të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin dhe/ose magazinimin e mallrave objekt kontrate.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë**, sipas formatit të mëposhtëm, ku të përcaktojë ambientin që disponon dhe statusin juridik të tij:

Nr	Vendodhja	Statusi
		Pronesi/qira/perdorim

